



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:211803

Datë: 06.06.2024

Numri i dokumentit: 05789848

PKR.nr.331/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, në përbërje nga trupi gjykues prej tre gjyqtarëve profesionistë, përkatësisht: Naser Foniqi – kryetar i trupit gjykues dhe **Fatime Dërmaku e Ertan Sejfulla, anëtarë të trupit gjykues**, me bashkëpunëtoren profesionale **Arbenita Hoxha Koleci**, në çështjen penale të akuzuarit **E.K.**, për shkak të veprës penale Kontrabandim me migrantë nga neni 170, par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës – në vijim KPRK, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda **PP.I.nr.987/2015, të datës 31.10.2023**, pas shqyrtimit fillestar dhe atij gjyqësor, të hapur për publikun, të mbajtur më datat: 03.11.2023; **11.03.2024, 18.03.2024, 26.03.2024, 30.04.2024 dhe 29.05.2024**, në të cilin kanë qenë të pranishëm prokurorët e shtetit Dulina Hamiti dhe Armend Hamiti, i akuzuari **E.K. me mbrojtësen e tij av. Eranda Mahmuti me autorizim dhe të dëmtuarit - dëshmitarët D.A., F.R.dhe A.B.**, me datë **29.05.2024**, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari E.K., i biri i Sh. dhe F., e vajzërisë Sh., i lindur me datë ..., në fshatin K., Komuna Podujevë, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar – baba i një fëmije, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike - shfrytëzues i pensionit të veteranit të luftës në shumë prej 170 euro, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, **ka qenë nën masën e arrestit shtëpiak nga data 04.10.2023 deri me datë 03.01.2024.**

ËSHTË FAJTOR

S e p s e: së bashku me persona të tjerë të pa identifikuar është marrë me kontrabandim të migrantëve, me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të dobisë financiare, duke i marrë për një person 1200-1600 euro, ashtu që fillimisht është takuar në Podujevë me të dëmtuarit A.B., D.A. dhe F.R., pastaj kanë arritur marrëveshjen që përmes lidhjeve të tij, t'i dërgoj të dëmtuarit e lartcekur nga Kosova në Austri, e për këtë kanë caktuar datën e nisjes për Austri, kështu që, në mëngjesin e datës 08.10.2015, në restorantin "M..." afër pikës kufitare në Mërdare të dëmtuarit janë takuar me të pandehurin e pas pak kohe te ata kishte shkuar edhe një person i pa njohur i nacionalitetit serb, i cili ishte bashkëpunëtor i të pandehurit, e nga aty të gjithë së bashku kishin kaluar kufirin dhe kanë vazhduar rrugën me veturën e personit të panjohur deri në Novi Sad, pastaj atje janë takuar me një person me emrin R., i cili i kishte marrë me veturën e tij, ndërsa i pandehuri E. është ndarë nga ta pasi kishin kaluar një rrugë me atë veturë, ndërsa tani të dëmtuarit si më lart kanë hyrë në një veturë tjetër të cilën e ka drejtuar një

shtetas serb, e pas tyre kishte vazhduar një veturë tjetër me dy persona brenda saj, duke i dërguar në një shtëpi për të fjetur, e aty kanë qëndruar deri të nesërmen në mbrëmje, nga ku, prapë kanë filluar rrugën me të njëjtën veturë deri sa janë ndalur nga pjesëtarët e policisë në Rumani, të cilët i kanë paraburgosur, me ç rast të dëmtuarit A. dhe F. kanë qëndruar nga 6 ditë ndërsa D. 15 ditë, e pastaj janë kthyer në Kosovë,-

- me këto veprime, ka kryer veprën penale Kontrabandim me migrantë nga neni 170, par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: 49; 50; 51; 52; 73; 75; 76 par. 1.4; 83, par. 1 dhe 170, par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK, si dhe nenit 364 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale - në vijim KPP, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË DHE ME BURGIM ME KUSHT

- **Dënim me gjobë në shumë prej njëmijë (1000) €, dhe**
- **Dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vite, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen në qoftë se i akuzuari në afat prej dy (2) vite, nuk do të kryej vepër të re penale.**
- Në dënimin e shqiptuar, të akuzuarit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak prej datës **04.10.2023 deri me datë 03.01.2024.**
- Obligohet i akuzuari **E.K.**, që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **njëqind (100) € dhe pesëdhjetë (50.00) €, për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit**, në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.
- **Të dëmtuarit: D.(H.)A.**, nga fshati H., Rr. "...", nr. ..., Komuna Prishtinë, **F.(J.)R.**, me banim në Prishtinë Rr. "...", nr. ..., dhe **A.(S.)B.**, me banim në fshatin L., rr. "...", pa numër, Komuna Podujevë, nuk udhëzohen në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike sepse gjatë shqyrtimit gjyqësorë kanë heqë dorë nga kjo e drejtë.

A R S Y E T I M I

Pas kallëzimit penal të Policisë së Kosovës/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Prishtinë DHTN1-DKKO, nr. 2015-DHKO-054, të datës 16.12.2015, Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën **PP.I.nr.987/2015, të datës 31.10.2023**, ka akuzuar të pandehurin **E.K.**, i akuzuar për shkak të veprës penale Kontrabandim me migrantë nga neni 170, par. 6 lidhur me par. 1 dhe 2 të KPRK.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 03.11.2023, prokurori i shtetit ka bërë precizimin e aktakuzës te kualifikimi juridik nga neni 170, par. 6, lidhur me par. 1 dhe 2 në neni 170 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e pas precizimit dhe leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari E.K. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe është deklaruar i pa fajshëm për veprën penale për të cilën është akuzuar, pastaj të njëjtit i është dhënë mundësia që në bazë të nenit 240, par. 7 të KPP, brenda afatit prej 30 ditësh, përkatësisht deri me datë 03.12.2023 të paraqes çdo kundërshtim ndaj provave të cekura në aktakuzë, në pajtim me nenin 243 të KPP dhe çdo kërkesë për hedhjen e aktakuzës, në pajtim me nenin 244, par. 1 të KPP.

Duke vendosur për kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, të ushtruar nga mbrojtësja e të akuzuarit, av. Eranda Mahmuti, si dhe përgjigjes së prokurorit të shtetit, kjo gjykatë me aktvendimin PKR.nr.331/2023 të datës 29.11.2023 ka refuzuar si të pabazuara kërkesat si më lart, sepse mbrojtja nuk ka ofruar prova të cilat do të ishin të mjaftueshme për ta hedhë aktakuzën dhe për shpalljen e provave të pa pranueshme.

Po ashtu, edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 11.03.2024, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari E.K. prapë është deklaruar i pa fajshëm për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, në fjalën e tij hyrëse, prokurori i shtetit ka deklaruar se aktakuza e ngritur nga prokuroria PP.I.nr.987/2015 e datës 31.10.2023, në çështjen penale të akuzuarit E.K., është e mbështetur në prova të mjaftueshme dhe se me dëgjimin e të dëmtuarve - dëshmitarëve A.B., F.R.e D.A. do të vërtetohet se i akuzuari E.K. ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Ndërsa, në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka deklaruar se me administrimin e provave dhe dëshmive gjatë shqyrtimit gjyqësor në mënyrë të plotë është vërtetuar se i akuzuari E.K. ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, e kjo është vërtetuar nga dëshmia e të dëmtuarve-dëshmitarëve A.B., F.R.dhe D.A. të dhëna në shqyrtim gjyqësor, e sipas të cilave në mënyrë të plotë është vërtetuar se i akuzuari E.K. ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Pastaj, prokurori i shtetit ka theksuar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin E.K. ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit për veprën penale Kontrabandim me migrantë nga neni 170, par. 1 lidhur me nenin 31 KPRK, ndërsa me rastin e marrjes së vendimit për dënimin të merr parasysh rrethanat rënduese se i pandehuri edhe më herët ka qenë i gjykuar për vepër penale siç ka deklaruar vet i akuzuari, derisa ka qenë në Austri.

I dëmtuari – dëshmitari D.A. në fjalën hyrëse ka deklaruar se pajtohet me fjalën hyrëse të prokurores së shtetit, duke shtuar se nuk ndihet i dëmtuar dhe nuk kërkon kompensim dëmi nga i akuzuari E.K..

I dëmtuari – dëshmitari F.R.gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk ndihet i dëmtuar në raport me E.K. e as nuk kërkon kompensim dëmi nga ai.

I dëmtuari – dëshmitari A.B. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk kërkon dëmshpërblim nga tani i akuzuari por ka kërkuar vetëm paratë e tij, të cilat gjatë shqyrtimit gjyqësor ka vendosur që t'ia falë që të mos i bëj keq atij.

Në fjalën e saj hyrëse mbrojtësja e të akuzuarit E.K., av. Eranda Mahmuti ka deklaruar se mbrojtja konsideron se aktakuza nuk ka bazë të vlefshme juridike dhe si e tillë nuk mund të qëndroj, pasi që ka mangësi të shumta dhe është e përbërë në përmbledhjen e tri deklaratave pa përshkrimin e asnjë prove, pa një analizë të qartë dhe të mirëfilltë, andaj si e tillë nuk ka mbështetje ligjore. Ndërsa në fjalën përfundimtare të përgatitur me shkrim, mbrojtësja Mahmuti fillimisht ka bërë përshkrimin e aktakuzës lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet i mbrojturi i saj E.K., pastaj ka konsideruar se aktakuza nuk mund të qëndroj sepse ajo çka mund të lexohej nga akti akuzues është përmbledhja e tri deklaratave duke mos përshkruar asnjë provë dhe pa asnjë analizë të qartë të rezultateve të hetimit, duke shtuar se aktakuzës i mungon elementi thelbësor, analiza se si ka ardhur prokurori në përfundim se i pandehuri ka kryer veprën penale që i vihet në barrë. Po ashtu, mbrojtësja M. ka theksuar se pas analizimit të deklaratave konsideron se nuk ka prova konkrete dhe nga deklaratat si ajo e D.A., i cili ka thënë se nuk kishte pasur asnjë lidhje me të mbrojturin e saj dhe kishte pohuar se nuk e kishte kaluar kufirin në

mënyrë ilegale dhe se nga ai nuk kishte marrë para E.K., e i njëjti nuk ishte përfshirë në rregullimin e ndonjë dokumentacioni apo ndonjë veprë penale. Pastaj, mbrojtësja Mahmuti ka përshkruar pyetjet e bëra nga KTGJ dhe ATGJ të cilat i janë bërë të pandehurit, e ku konsideron se nga përgjigjet e tij vërehet se i mbrojturi i saj nuk kishte përfituar dobi pasurore dhe nuk kishte qenë organizator për udhëtimin e tyre por ai ishte pjesëmarrës në udhëtim pasi që edhe ai kishte pretendime për të udhëtuar jashtë vendit. Mbrojtësja, po ashtu ka shtuar se për tu kryer vepra penale e cila i vihet në barrë të mbrojturit të saj duhet të plotësohen elementet e veprës penale: veprimi, kundërligjshmëria, përcaktueshmëria dhe fajësia e të cilat në asnjë pikë të njëjtat nuk gjejnë zbatim, pastaj ka analizuar deklaratën e dëshmitarit A.B. duke konsideruar se deklaratat e tij janë kundërtënëse duke thënë se herë kishte udhëtuar me veturë e herë me autobus por e rëndësishme ishte se ai gjithmonë kishte thënë se E.K. nuk i kishte dhënë para por kishin pasur një detyrim ndaj serbëve dhe se gjatë gjithë kohës roli i tij kishte qenë i viktimës, ndërsa nga deklaratat e të dëmtuarit A.B. shihet qartë se ky organizim nuk ka qenë nga ana e E.it dhe ai nuk ka marrë para për udhëtim, por E. ishte vetëm një bashkudhëtarë i këtyre të pretenduarve të dëmtuar, por thekson se gjetja e taksisë për të mbrojturin e tij i kushtoj një aktakuzë të pavlefshme dhe pa bazë ligjore, pasi në këtë rast nuk kemi veprime të kundërligjshme të cilat vërtetojnë se i mbrojturi i saj ka kryer veprën penale si në aktakuzë, përkatësisht nuk ka prova materiale, nuk është vërtetuar që i mbrojturi i saj kishte për qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të dobisë financiare, pastaj prokuroria ka dështuar të argumentoj me prova të pranueshme se i mbrojturi i saj ka kryer veprë penale për të cilën akuzohet, duke mos respektuar nenin 48 të KPP, i cili prokurorinë e detyron të analizoj provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese, pasi që i pandehuri nuk ka detyrim që ta vërtetojë pafajësinë pasi vetë ligji ia ka dhënë atë atribut dhe se barra e provës bie mbi prokurorinë. Në fund të fjalës së saj përfundimtare, mbrojtësja e të akuzuarit ka thënë se i mbrojturi i saj nuk kishte motiv, dashje, përfitim pasuror e asnjë element tjetër dhe përfundimisht nuk është kryerës i veprës penale, andaj deklaratat e të dëmtuarve – dëshmitarëve dhe shkresat e lëndës, sipas saj tregojnë qartë se i mbrojturi i saj nuk ka pasur pjesëmarrje në veprën penale të kontrabandimit e për këtë arsye ka propozuar që për të njëjtin të merret aktgjykim lirues.

Në fjalën e tij hyrëse, i akuzuari E.K. ka deklaruar se e përkrah fjalën hyrëse të mbrojtëses se tij. **Ndërsa, në fjalën përfundimtare i akuzuari E.K. ka deklaruar se** e ka lexuar fjalën përfundimtare të mbrojtëses se tij, ka dëgjuar edhe thënie të saj në seancë, i mbështet fjalët e mbrojtëses se tij duke shtuar se ai ka qenë i dënuar më parë në Austri por jo për kontrabandim me migrantë dhe këtë e ka treguar vetëm për shkakun se ka dashur ta thotë të vërtetën pa fshehur asgjë dhe se është i pafajshëm në këtë rast.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor janë dëgjuar dëshmitarët – të dëmtuarit D.A., F.R. dhe A.B. dhe i akuzuari ka dhënë mbrojtjen e tij, e të paraqitura si në vijim:

Dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit D.A., i cili pasi është njoftuar me të drejtat e dëshmitarit, nën betim, në pyetje nga prokurori i shtetit ka deklaruar se data e saktë nuk i kujtohet, por viti ka qenë 2015 kur në mëngjes janë nisur me F.R. për në Austri, duke shtuar se F. e ka njohur përmes kushëririt të tij F.A., dhe se me F. ishin takuar 1-2 ditë para se të niseshin për në Austri, e aty i pranishëm kishte qenë edhe F.A.. Pastaj i dëmtuari – dëshmitari D.A. ka thënë se për në Austri janë nisur ilegalisht, pa viza pasi që me F.R. ishin takuar në Prishtinë, rrugës për në Gërmicë, ku kishin pirë kafe dhe kishin diskutuar se si të niseshin - si të udhëtonin, e pastaj F. kishte kontaktuar me dikë të panjohur për të, e të cilit ia ka paguar 1500 euro F. për udhëtimin deri në Austri, por nuk e di te kush kanë shkuar ato para pasi ka kaluar një kohë e gjatë dhe nuk i di detajet.

Pasi prokurori i shtetit e ka ballafaquar dëshmitarin D.A. me deklaratën e dhënë në polici me datë 10.12.2015, në faqen 2 ku ka deklaruar: “po e tregoj se si ka rrjedh e gjithë ngjarja pasi që unë isha i interesuar që unë të shkoj në Zvicër, kërkoja njerëz që të më ndihmojnë të dal në të zezën pasi që unë nuk kisha vizë, përmes shokut tim F.R.kuptova se një person nga rrethina e Podujevës i quajtur E. të cilin e thërrisnin C.mund të na ndihmonte përmes lidhjeve të tij që të shkojmë deri në Austri dhe për këtë rrugëtim duhet t’i paguanim 1600 euro kur të mbërrijmë në destinacionin e fundit në Austri”, në pyetje se a është e saktë kjo që ka thënë në polici, i dëmtuari - dëshmitari D.A. është përgjigjur se kështu ka deklaruar. Po ashtu, i dëmtuari – dëshmitari **D.A.** ka thënë se kur janë nisur me F.R. pak pa shku në kufi janë ndalur te një kafe afër kufirit në Merdare, aty ka ardhur tani i akuzuari E., pastaj F. dhe E. kanë shkuar dhe i kanë lënë diku paratë e tij dhe ato të F., e të cilin person e njihnin edhe E.i edhe F., pastaj kanë kaluar kufirin, e aty iu është bashkangjitur A.B., pastaj matanë kufirit kanë hipur në një veturë Golf 2, e cila i ka dërguar deri matanë Beogradit, por gjatë rrugës E. ka zbritur nga Golfi 2, pastaj kur e kanë kaluar Beogradin kanë hipur në një veturë tjetër në të cilën ndodheshin dy qytetarë serb me të cilët kanë vazhduar deri në Suboticë, e derisa kanë tentuar të kalojnë kufirin Serbi – Rumani i kanë zënë dhe ndaluar policia rumune, dhe aty ka qëndruar dy javë në paraburgim, ndërsa F. dhe A. i kanë kthyer prapa pasi kanë pasur pasaporta serbe, duke theksuar se kur është liruar nga autoritetet rumune, ai ka udhëtuar për në Turqi e nga aty është kthyer në Kosovë, e pastaj F.R.ia ka kthyer paratë në shumë prej 1500 apo 1600 euro.

Në pyetje nga mbrojtësi i të akuzuarit, D.A. është përgjigjur se nuk e di në çfarë cilësie ka qenë E.i me ta, si udhëtarë apo si diçka tjetër, pasi me të ka biseduar F.R., duke shtuar se taksinë nga Merdarja deri matanë Beogradit ai nuk e ka paguar, duke theksuar se ajo me siguri ka hyrë në shumën prej 1600 euro për udhëtimin, por se tani i akuzuari E. as nuk e ka pajisur me dokumente udhëtimi e as nuk i ka premtuar e as garantuar për udhëtimin e tij deri në Austri.

I akuzuari E.K. ka thënë se nuk ka pyetje për të dëmtuarin D.A., por ka vërejtje sa i përket çështjes së dëshmitarit nuk i kujtohet pagesa e taksisë, sepse që të katërtit kanë paguar nga 50 euro për taksinë gjatë rrugës, duke shtuar se është e vërtetë se ai ka zbritur më herët gjatë rrugës pasi kur kanë mbërrirë në Novi Sad, personi që ka pasur për t’i dërguar në Austri me mbiemër Toplica i ka thënë se e ka edhe një person dhe se ai duhet të zbres dhe ta pres turnin tjetër, pastaj ai ka zbritur dhe ka pritur në hotel deri të nesërmen dhe të nesërmen personi me mbiemrin Toplica i ka thënë se nuk ka mundësi ta dërgoj në Austri, por ai ka vazhduar rrugën vet, ka shkuar në Suboticë dhe ka kërkuar ndonjë person që të mund ta dërgoj në Austri, por nuk ka arritur dhe është kthyer në shtëpi.

Në pyetje nga KTGJ, D.A. ka thënë se F.R. ka thënë se e ka një njeri të besueshëm për t’i dërguar deri në Austri por nuk e di kush ka qenë ai person pasi që i ka besuar F. dhe se nuk e di arsyen se përse E. gjatë rrugës ka zbritur nga vetura me të cilën udhëtonim së bashku, por i njëjti - E. ka qenë i heshtur, ka qëndruar më shumë në telefon e gjatë kohës sa kanë tentuar ta kalojnë kufirin Serbi- Rumani, ata i kanë shoqëruar dy qytetarët serb të cilët i kishin sjellë me veturë deri aty dhe me ta ka komunikuar F., pasi ai e ka ditur gjuhën. **D.A. ka thënë se nuk mendon se tani i akuzuari E. ka qenë organizator i udhëtimit për në Austri.**

Në pyetje nga ATGJ Fatime Dërmaku, i dëmtuari - dëshmitari D.A. është përgjigjur se personalisht nuk është marrë vesh me E.K. që ai t’i dërgoj në Austri, e i njëjti në asnjë formë direkt apo indirekt nuk ka kërkuar nga ai të holla - para për ta dërguar në Austri, por nuk e di a i ka kërkuar para F., duke shtuar se E.i nuk i ka siguruar dokumentacion për të udhëtuar për në Austri, pasi ai është nisur me letërnjoftim të Kosovës.

Dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit F.R., i cili pasi është njoftuar me të drejtat e dëshmitarit, nën betim, në pyetje nga prokurori i shtetit ka deklaruar se i njeh personat me emrat A.B., D.A.n dhe E.K.n, për të cilin ka thënë se kanë dashur të udhëtojnë së bashku, në të zezën për në Gjermani, dhe se me të janë njoftuar në kafene në Podujevë, duke shtuar se me të

lantcekurit janë nisur me autobus në drejtim të Beogradit, pastaj në Beograd kanë hipur në një autobus tjetër për në Novisad, e aty janë takuar me një rom, emrin e të cilit e ka harruar, e i cili i ka marrë dhe i ka dërguar në një fshat të Serbisë afër kufirit me Rumaninë, e aty i ka dorëzuar te dy qytetarë serb me të cilët kanë udhëtuar arave deri brenda kufirit në Rumani, e deri sa kanë tentuar ta kalojnë kufirin Rumani- Hungari i kanë zënë dhe i kanë ndaluar policia rumune, pastaj në Rumani ka qëndruar 7 ditë në burg. Po ashtu, F.R. ka thënë se me E.K., A.B. dhe D.A. janë marrë vesh të udhëtojnë bashkë por pastaj ka ndryshu hesapi dhe me sa i kujtohet kur të mbërrinte në Gjermani ka pasur për t'i paguar 800 euro për udhëtimin, e këto para ka pasur për detyrim tua jap qytetarëve serb të cilët i kanë dërguar deri në Rumani.

Prokurori i shtetit e ka ballafaquar dëshmitarin R. me deklaratën e dhënë në polici me datë 09.12.2015, fundi i faqes 2, fillimi i faqes 3, ku ka deklaruar “diku në muajin shtator pasi që isha i interesuar të shkoj në Gjermani, dëgjova se një person nga Podujeva ka mundësi me më ndihmu të më dërgoj në Gjermani i cili quhej N., shkova në Podujevë në kafeterinë K... dhe aty pyeta disa persona a e njeh dikush këtë person, ata më thanë se është nga D. e Podujevës dhe aty një person më tha nëse e ke për me dalë jashtë Kosovës tash vjen një person tjetër që mundet me të dërgu deri në Austri, unë i thash po, për me dalë jashtë po më duhet dhe për një kohë të shkurtër erdhi një person dhe u ul në tavolinë dhe aty ishte edhe një person tjetër të cilin nuk ia di emrin, ndërsa personi që unë lidha marrëveshje për të më dërguar deri në Austri quhej E.K., të cilin e quanin me pseudonimin C., marrëveshja me të u bë që unë t'ia paguaj 1300 euro deri në Vjenë, ku E.i kishte për obligim të na dërgonte deri në Novi Sad te një person i quajtur R., ndërsa prej aty R.i me bashkëpunëtorët e tij të na dërgoj deri ne Austri” a qëndron kjo që keni deklaruar në polici?, i dëmtuari – dëshmitari F.R. është përgjigjur se për punën e pagesës ka harruar, por para nuk ka dhënë, sepse nuk ka pasur nevojë t'i paguaj ato pasi nuk ka mbërri në vendin për ku ishte nisur.

Prokurori i shtetit prapë e ka ballafaquar R. me deklaratën e dhënë në polici me datë 09.12.2015, fundi i faqes 3, ku ka deklaruar “E. më tha se unë do t'iu përcjelli deri në Novi Sad, kufirin Kosovë – Serbi do ta kalojmë këmbë në mënyrë të rregullt, në pjesën e Serbisë posa ta kalojmë kufirin na pret një taksist serb i cili na dërgon deri në Novi Sad, atje takojmë personin me emrin R. i cili është i nacionalitetit rom dhe nga aty R.i përmes disa bashkëpunëtorëve serb do t'iu dërgoj në Hungari pastaj nga Hungaria në Austri dhe paratë kemi pas me i lanë në një vend të caktuar dhe pasi të mbërrim në ne në Austri ato para në vlerë prej 1300 euro ka pas me shku me i marrë motra e këtij R. e cila po banonte diku në Podujevë, mirëpo motrën e R. unë nuk e njoh dhe nuk e di as ku banon” a qëndron kjo që keni deklaruar në polici?, dëshmitari F.R. ka pohuar thëniet e tij në polici, duke shtuar se nuk është i sigurt nëse kur është kthyer nga Rumania të jetë takuar me E. sepse mesa di ai, në atë kohë E. ka udhëtuar për në Austri, por kur ky – dëshmitari R. ishte kthyer nga Rumania është takuar me një familjar të E., por para E. e as familjarëve të tij nuk i ka dhënë.

Po ashtu, pasi prokurori i shtetit e ka ballafaquar dëshmitarin R. me deklaratën e dhënë në polici me datë 09.12.2015, faqe 3 ku në pyetje të policisë “Pasi u kthyet a e takuat E.” ju jeni përgjigjur “po”, a qëndron kjo që keni deklaruar në polici?, dëshmitari R. ka thënë se kanë kaluar 9 vite, por nëse e ka thënë ashtu, ashtu është.

Prokurori i shtetit përsëri e ka ballafaquar dëshmitarin R. me deklaratën e dhënë në polici me datë 09.12.2015, faqe 3 ku në pyetje të policisë “Çka ndodhi me paratë, me shpenzimet, etj.” ju jeni përgjigjur “E.i na ka thënë se shpenzimet që i keni bërë ua kthej por njëherë nuk kam para dhe na kërkonte falje për dështimin e realizimit të udhëtimit”, a qëndron kjo që keni deklaruar në polici?, dëshmitari R. ka thënë se nëse e ka thënë ashtu, ashtu është.

Prokurori i shtetit e ka ballafaquar dëshmitarin R. me deklaratën e dhënë në polici me datë 09.12.2015, faqe 3, ku në pyetje të policisë “a ke shkuar t'i ndonjëherë të E. që t'i kërkosh paratë e shpenzimeve”, ju jeni përgjigjur “kam shkuar, jam takuar me babain e tij i cili quhej Sh. dhe ai me tregoj se E. është arrestuar në Austri dhe atje është dënuar më 7 vite burg”, a qëndron

kjo që keni deklaruar në polici?, dëshmitari R. ka pohuar se ashtu ka qenë, duke shtuar se lidhur me këtë rast nuk ka dhënë deklaratë në prokurori, por tash po e sheh se paska dhënë deklaratë në prokurori me datë 19.10.2016, dhe se qëndron pranë deklaratave të dhëna në polici dhe prokurori.

Në pyetje nga mbrojtësi i të akuzuarit, **dëshmitari R. është përgjigjur se E.** ka pasur tjetër rol por ka shkuar bashkë me ata deri në Novi Sad me sa i kujtohet dhe se sipas tij, roli i E. ka qenë viktimë sikur edhe për të tjerët, pasi E. nuk i ka premtuar as për dokumente sepse po të kishte pasur dokumente nuk do të ishte nisur në të zezën.

I akuzuari ka thënë se nuk ka pyetje po ka disa sqarime për dëshmitarin pasi që nuk janë nisur me autobus dhe se ai nuk ka qenë organizatori, pasi ai dhe familja e tij kanë pasur një taksist serb të njohur, me të cilin kanë udhëtuar prej kufirit në Merdare deri në Novi Sad, e kjo ka qenë një marrëveshje në mes tij, F., A. dhe D., që të mos maltretoheshin me autobusa, e për e ka thirrur taksistin si më lart, të cilin e kanë paguar të katërtit nga 50 euro, e pastaj, i dëmtuari R. ka thënë se tani i kujtohet se ashtu ka qenë siç po e thotë i akuzuari.

Në rimarrja në pyetje nga prokurori i shtetit, dëshmitari R. është përgjigjur se nëse do të kishte arritur deri në Austri, paratë për udhëtimin ka pasur për t'i marrë motra e R.

Prokurori i shtetit e ka ballafaquar dëshmitarin R. me deklaratën e dhënë në prokurori me datë 19.10.2016, ku ka deklaruar "kështu që jam takuar me E., kemi arritur marrëveshje që ditën e nisjes t'i lëmë te një person në Podujevë për me qenë si garancion se nëse unë dal në Austri paratë mi marrë E., ndërsa nëse nuk dal me mi kthy të hollat mua, atij personi nuk ia di emrin por rrinte bashkë me E. dhe me sa kam dëgju ka shku në Gjermani, i njëjti kur unë jam kthyer në Kosovë ai mi ka dhënë 1300 euro", a qëndron kjo që keni deklaruar në prokurori?, dëshmitari R. ka thënë se para nuk ka dhënë, këtë e ka deklaruar edhe në polici dhe prokurori që E. para nuk i ka dhënë, përkatësisht paratë ka pasur për t'i dhënë pasi të mbërrinte në Austri.

Në pyetje nga KTGJ, **dëshmitari R. ka thënë se** nuk e di se si është shënuar përgjigjja si më lart, por atij as që po i kujtohet që ka dhënë deklaratë në prokurori, por e pa në procesverbal dhe nënshkrimi është i tij, duke shtuar se për këtë rast nuk ndihet i dëmtuar në raport me E.K.e as nuk kërkon kompensim dëmi nga ai.

Dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit A.B., i cili pasi është njoftuar me të drejtat e dëshmitarit, nën betim, në pyetje nga prokurori i shtetit ka deklaruar se në lidhje me këtë rast ka dhënë deklaratë në polici dhe qëndron pranë asaj deklaratë, duke shtuar se me tani të akuzuarin janë njohur moti sepse janë nga i njëjti vend - Podujeva, dhe se ai – dëshmitari B. ka dashur të dal jashtë vendit, ndërsa tani i akuzuari E. i ka thënë se mund të dalin jashtë vendit, e me ta ishin edhe dy persona të tjerë, përkatësisht F. dhe një tjetër, e aty E. i kishte thënë se serbët i kërkojnë 1200 euro për udhëtimin deri në Austri, ndërsa për siguri të parave, të njëjtat ia ka dhënë E., pastaj kanë udhëtuar nëpër Serbi, janë takuar me një serb me emrin D. me të cilin kanë vazhduar rrugën, kanë kaluar kufirin Serbi- Rumani në të zezën, pastaj kanë vazhduar drejt kufirit Rumani-Hungari, dhe në Hungari e ka zënë policia dhe e ka kthyer në Rumani, e aty i kanë dërguar të gjithë në burg, kanë qëndruar një natë, pastaj e kanë dërguar në rehabilitim, e pastaj e kanë kthyer në Serbi, ku ka qëndruar pesë ditë në rehabilitim, e pastaj e kanë lëshuar dhe është kthyer në Podujevë, derisa pas tri ditëve e ka thirrur policia nga Prishtina që të paraqitet në stacion. Po ashtu, **dëshmitarit B.** ka thënë se pasi është kthyer në Kosovë është takuar me E., të cilit ia ka kërkuar paratë që ia kishte dhënë për siguri për udhëtim, e ai – E. i kishte thënë se nuk i ka tani për tani po se do t'ia jap më vonë, e pastaj E. ka shkuar jashtë vendit dhe i kishte thënë se paratë i merr te familja e tij, e të cilat ia ka dhënë babai i tij, por i ka mbetur borxh 430 euro, të cilat nuk i kërkon nga i akuzuari sepse ka kaluar kohë e gjatë.

Mbrojtësja e të akuzuarit ka thënë se nuk ka pyetje për të **dëmtuarin - dëshmitari A.B. e as vërejtje në thëniet e tij.**

Edhe i akuzuari ka thënë se nuk ka pyetje por ka vërejtje me arsyetim se dëshmitari nuk e ka thënë të vërtetën sepse kur është kthyer nga Serbia ai është takuar me të dhe shkurt e shqip,

A. i ka kërkuar dëmshpërblim për shpenzimet e krijuara të tij, pastaj dëshmitari A. ka shkuar disa herë te babai i tij dhe i ka marrë paratë, bile edhe ka kërcënuar.

Pas i akuzuari ka bërë vërejtje për thëniet e tij, dëshmitari B. ka thënë se nuk ka kërkon dëmshpërblim nga tani i akuzuari por ka kërkuar vetëm paratë e tij, të cilat gjatë shqyrtimit gjyqësor ka vendosur që t'ia falë që të mos i bëjë keq atij, duke shtuar se nuk e ka kërcënuar babanë e tani të akuzuarit.

Në pyetje nga KTGJ, **dëshmitari B. ka thënë se** me tani të akuzuarin nuk kanë pasur marrëveshje që ai t'i dërgoj në Austri sepse tani i akuzuari nuk ka mundur ta bëjë një gjë të tillë, këtë kanë pasur për ta bërë serbët siç e ka përmendur më lart dhe ata i kanë shoqëruar gjatë udhëtimit.

Në pyetje nga ATGJ Fatime Dërmaku, **dëshmitari B. është përgjigjur se** nuk e di cili ka qenë roli i E. gjatë udhëtimit të tyre, por atij ia ka dhënë paratë për siguri, përndryshe këto para do të ishte dashur t'ua jepte serbëve.

Pas paraqitjes si prova materiale nga prokurori i shtetit të deklaratave të dëmtuarve - dëshmitarëve A.B., F.R.dhe D.A. të dhëna në polici dhe prokurori me datat 19.10.2016 dhe 10.12.2015, pas këshillimit dhe votimit trupi gjykues ka marrë aktvendim me të cilin ka vendosur se nuk mund të administrohen si prova materiale deklaratat e të dëmtuarve - dëshmitarëve A.B., F.R.dhe D.A. të dhëna në polici dhe prokurori me datat 19.10.2016 dhe 10.12.2015 sepse këta të dëmtuar dëshmitarë janë dëgjuar gjatë këtij shqyrtimi gjyqësorë, prokurori i shtetit dhe i akuzuari me mbrojtësen e tij kanë pasur rastin t'iu bëjnë pyetje, t'i ballafaqojnë me këto deklarata dhe i akuzuari të jap sqarime lidhur me dëshmitë e tyre në shqyrtim gjyqësor dhe se leximi i këtyre deklaratave si prova do të mund të bëhej vetëm në rastet kur gjykata nuk do të mund të siguronte praninë e tyre në procedurë.

Pasi është njoftuar me të drejtat e tij, në bazë të nenit 344 të KPP, se ka të drejtë të mos deklarohet, e nëse zgjedh të deklarohet marrja e tij në pyetje do të zbatohet në pajtim me paragrafët 2 dhe 4 të këtij neni, i akuzuari E.K. ka thënë se do ta shfrytëzoi të drejtën e tij për të deklaruar dhe në pyetje nga mbrojtësi i tij është përgjigjur se organizator i udhëtimit i cili është objekt i aktakuzës, ka qenë një person nga Serbia përkatësisht R. T., e këtë e ka thënë para hetuesve sepse është një person tjetër të cilit nuk guxon t'ia përmend emrin, e i cili ka organizuar udhëtimin dhe se i njëjti ka pasur lidhje me R. T., duke shtuar se për këtë udhëtim, ai, F.R., A.B. dhe D.A. janë takuar pasi kanë biseduar nëse mund të shkojnë me autobus apo me taksì deri në Novi Sad, pastaj kanë vendosur që të udhëtojnë me taksì, e ku në fillim kanë paguar taksinë secili nga 50 euro në vlerë totale prej 200 euro, taksisti ka qenë qytetar serb me veturë private, me të janë nisur nga Merdarja deri në Novi Sad, e pasi kanë arritur në Novi Sad, atje i ka pritur R. T. a, i cili është prezantuar me këtë emër dhe i njëjti iu ka thënë se njëri nga udhëtarët duhet të zbres për shkak se me R. ka qenë edhe një person tjetër, i cili duhej të hipte në veturë ndërsa njëri nga këta të zbrisnin, e aty R. kishte vendosur që të zbres E., pastaj ai ka zbritur dhe ka shkuar në hotel pasi e kam njohur qytetin dhe atë natë ose të nesërmen R. e ka thirrur në telefon dhe i ka thënë se nuk mund ta depërtoj për në Austri, e pastaj E. ka shkuar në Suboticë që ta kërkoj dikë tjetër për ta depërtuar për në Hungari por nuk ka gjetur zgjidhje dhe është kthyer në shtëpi në fshatin K., Komuna Podujevë.

Në pyetje nga prokurori i shtetit, i akuzuari ka thënë se A.B.n e ka njohur më herët ndërsa F. dhe D. nuk i ka njohur më parë dhe pas kësaj ngjarje është takuar edhe njëherë me F. dhe D. në Podujevë për shkak se ata i kanë kërkuar nga E. shpenzimet e udhëtimit, sepse ai e kishte filluar bisedën te kufiri në Merdare me personat që kanë udhëtuar për shkakun si të udhëtojnë dhe me çka të udhëtojnë. I akuzuari ka refuzuar të përgjigjet në pyetjen e prokurorit të shtetit nëse ua ka kthyer ose jo shpenzimet e udhëtimit A., F.dhe D.

Në pyetje të KTGJ, i akuzuari është përgjigjur se A., F. e D. si me kërcënim i kanë kërkuar shpenzimet e tyre edhe pse atyre nuk iu ka premtuar se do ta kalonin me siguri kufirin, pasi edhe vet ishte kthyer në shtëpi pasi nuk kishte arritur ta kaloj kufirin në Hungari, duke përsëritur se nuk po guxon t'ia përmend emrin e personit që është kyç në këtë rast, e të cilin në atë kohë të gjithë në Podujevë e kanë njohur që qet jashtë njerëz me pagesë.

Në pyetje nga ATGJ Fatime Dërmaku, i akuzuari ka thënë se F. dhe A. e kanë ditur shumë mirë se me kë kanë folur dhe kujt ia kanë dhënë paratë, por kanë menduar se gjoja ai – tani i akuzuari është me të, duke pasur parasysh edhe atë se ai e ka thirrur taksistin e për këtë ata janë munduar t'i marrin nga ai shpenzimet e udhëtimit, por D. nuk ka pasur kështu kërkesa për kthimin e shpenzimeve.

Në pyetjen e ATGJ Ertan Sejfulla, i akuzuari është përgjigjur se asnjëri nga ata gjatë udhëtimit nuk ka pasur ndonjë rol udhëheqës, por R. T. ka pasur detyrim t'i dërgoj deri në Vjenë - Austri.

Aktgjykimi si më lart është bazuar vetëm në faktet dhe provat e proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor, siç parasheh dispozita e nenit 360 të KPP, e për të cilat do të jepet vlerësimi si në vijim:

Nga dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit D.A., është vërtetuar se në një mëngjes të vitit 2015 janë nisur me F.R.n për në Austri, pasi F. kishte kontaktuar me dikë të panjohur për të, e të cilit ia ka paguar 1500 euro për udhëtimin deri në Austri, por nuk e di te kush kanë shkuar ato para pasi ka kaluar një kohë e gjatë dhe nuk i di detajet.

Pas ballafaqimit me deklaratën e dhënë në polici me datë 10.12.2015, në faqen 2 ku kishte deklaruar: “isha i interesuar që unë të shkoj në Zvicër, kërkoja njerëz që të më ndihmojnë të dal në të zezën pasi që unë nuk kisha vizë, përmes shokut tim F.R.kuptova se një person nga rrethina e Podujevës i quajtur E. të cilin e thërrisnin C. mund të na ndihmonte përmes lidhjeve të tij që të shkojmë deri në Austri dhe për këtë rrugëtim duhet t'i paguanim 1600 euro kur të mbërrijmë në destinacionin e fundit në Austri”, dëshmitari D.A. është përgjigjur se kështu ka deklaruar dhe se pastaj F. dhe E.i kanë shkuar dhe i kanë lënë diku paratë e tij dhe ato të F., e të cilin person e njihnin edhe E. edhe F., pastaj kanë kaluar kufirin, e aty iu është bashkangjitur A.B..

Sipas thënieve të **dëmtuarit - dëshmitarit D.A. është vërtetuar se i akuzuari E.K. ka qenë i implikuar në veprën penale për të cilën është shpallur fajtorë sepse dëshmitari A. ka pohuar si më lart se** personi i quajtur E. të cilin e thërrisnin C. mund t'i ndihmonte përmes lidhjeve të tij që të shkojnë deri në Austri dhe për këtë rrugëtim duhet t'i paguanin 1600 euro kur të mbërrijmë në destinacionin e fundit në Austri.

Nga dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit F.R., është vërtetuar se ai me A.B., D.A. dhe E.K., kanë dashur të udhëtojnë së bashku në të zezën për në Gjermani, dhe se kur të mbërrinin në destinacion, për udhëtimin është dashur t'i paguajnë nga 800 euro qytetarëve serb të cilët i kanë dërguar deri në Rumani. Po ashtu, nga dëshmitari R., është vërtetuar se ai ka arritur marrëveshje për ta dërguar deri në Austri me personin që quhej E.K., të cilin e quanin me pseudonimin C., dhe se marrëveshja me të ishte që atij t'ia paguaj 1300 euro deri në Vjenë, e për këtë tani i akuzuari kishte për obligim t'i dërgonte deri në Novi Sad te një person i quajtur R., i cili me bashkëpunëtorët e tij do t'i dërgonte deri në Austri. Kjo vërtetohet edhe nga thëniet e dëshmitarëve tjerë dhe vet të akuzuarit, i cili ka zbritur nga vetura e cila po i dërgonte drejt kufirit me Rumaninë dhe me ta ka vazhduar rrugën personi me emrin R., ashtu siç ishin marrë vesh para se të niseshin nga Kosova.

Nga **dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit R., është vërtetuar edhe fakti se tani i akuzuari E. i ka përcjellë deri në Novi Sad, e pastaj E.i ka zbritur dhe të tjerët kanë vazhduar rrugën me personin me emrin R., i nacionalitetit rom, i cili përmes disa bashkëpunëtorëve serbë i ka dërguar**

ata drejt Hungarisë, e po ashtu, pasi udhëtimi kishte dështuar, i akuzuari E., iu kishte thënë se shpenzimet që i kanë bërë ua kthen por njëherë nuk ka para, si dhe u ka kërkuar falje për dështimin e realizimit të udhëtimit, e për këtë **dëshmitarit R.** kishte shkuar te shtëpia e tani të akuzuarit e aty ishte takuar me babain e tij, Sh., i cili i kishte treguar se E. është arrestuar në Austri dhe atje ishte dënuar me 7 vite burg.

Edhe nga thëniet e **dëshmitarit R., se është** takuar me E., kanë arritur marrëveshje që ditën e nisjes paratë t'i lënë te një person në Podujevë për me qenë si garancion se nëse del në Austri paratë mi marrë E., ndërsa nëse nuk del paratë t'ia kthej atij, dhe se kur është kthyer në Kosovë, ai - E. ia ka dhënë 1300 euro, e me këtë vërtetohet se tani i akuzuari ka kryer veprimet e përshkruara në aktakuzë dhe veprën penale Kontrabandim me migrantë nga neni 170, par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK.

Nga dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitarit A.B., është vërtetuar se atij, F. dhe një personi tjetër, tani i akuzuari E. iu ka thënë se mund të dalin jashtë vendit dhe se për këtë serbët i kërkojnë 1200 euro për udhëtimin deri në Austri, ndërsa për siguri të parave, të njëjtat ia ka dhënë E., pastaj kanë udhëtuar nëpër Serbi, e gjatë rrugës janë takuar me një serb me emrin D. me të cilin kanë vazhduar rrugën, kanë kaluar kufirin Serbi- Rumani në të zezën, pastaj kanë vazhduar drejt kufirit Rumani-Hungari, ku i kishte zënë policia dhe pas disa ditësh ishte kthyer në Kosovë, e ku ishte takuar me E., të cilit ia kishte kërkuar paratë që ia kishte dhënë për siguri për udhëtim, e ai - E. i kishte thënë se nuk i ka tani për tani por se do t'ia jap më vonë, e pastaj E. kishte shkuar jashtë vendit dhe i kishte thënë se paratë i merr te familja e tij, e të cilat ia ka dhënë babai i tij, por i ka mbetur borxh 430 euro, të cilat nuk i kërkon nga i akuzuari sepse ka kaluar kohë e gjatë.

Edhe nga thëniet e **dëshmitarit B., është** vërtetuar se **tani i akuzuari ka kryer veprimet e përshkruara në aktakuzë dhe** veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mbrojtjen e të akuzuarit E.K., se organizator i udhëtimit i cili është objekt i aktakuzës, ka qenë një person nga Serbia përkatësisht R. T. dhe se është një person tjetër të cilit nuk guxon t'ia përmend emrin, e i cili ka organizuar udhëtimin dhe se i njëjti ka pasur lidhje me R. T., trupi gjykues i ka vlerësuar si shmangie nga përgjegjësia penale sepse thëniet e dëshmitarëve si më lart janë në kundërshtim me mbrojtjen e të akuzuarit, përkatësisht të tre dëshmitarët njëjtë kanë deklaruar se kanë qenë të interesuar të udhëtojnë drejt Austrisë pa viza, dhe se për ta realizuar këtë udhëtim janë marrë vesh me tani të akuzuarin te i cili i kanë lënë edhe paratë që pasi të realizonin udhëtimin e planifikuar ato para t'i merrte i akuzuari, e nëse udhëtimi do të dështonte, ato para do të duhej t'iu ktheheshin tani të dëmtuarve – dëshmitarëve, siç edhe ka ndodhur me dëshmitarit R., të cilit tani i akuzuari E. ia ka kthyer 1300 euro, e po ashtu, edhe të dëmtuarit - dëshmitarit A.B. paratë ia kishte dhënë babai i tani të akuzuarit, Sh., por i kishte mbetur borxh 430 euro, të cilat gjatë shqyrtimit gjyqësor tani i dëmtuari B. ka vendosur të mos i kërkoj më nga i akuzuari.

Pretendimet e mbrojtëses së të akuzuarit të paraqitura **në fjalën e saj hyrëse dhe atë përfundimtare** se aktakuza është përmbledhja e tri deklaratave pa përshkruar asnjë provë dhe pa asnjë analizë të qartë të rezultateve të hetimit, dhe se për tu kryer vepra penale e cila i vihet në barrë të mbrojturit të saj duhet të plotësohen elementet e veprës penale: veprimi, kundërligjshmëria, përcaktueshmëria dhe fajësia e të cilat në asnjërën pikë të njëjtat nuk gjejnë zbatim, bie ndesh me dëshmitë e dëshmitarëve **F.R., D.A. e A.B.,** të cilët në detaje kanë përshkruar veprimet e të akuzuarit E., të paraqitura si më lart.

Pas dëgjimit të dëmtuarve – dëshmitarëve dhe mbrojtjes së të akuzuarit, trupi gjykues ka ardhur në përfundimin se i akuzuari **E.K.,** ka kryer veprën penale Kontrabandim me migrantë

nga neni 170, par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK, ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që ndaj të akuzuarit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese si në vijim intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, përkatësisht në rastin konkret viktimat e trafikimit nuk kanë pësuar ndonjë dëmtim trupor e as material pasi sipas tyre, tani i akuzuari i ka kompensuar shpenzimet e tyre dhe sjellja e të akuzuarit para dhe pas kryerjes së veprës penale, pasi që, për të njëjtin sipas evidencës së kësaj gjykate - sistemit SMIL, i njëjti nuk është gjykuar më parë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata ka marrë parasysh shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të akuzuarit në kryerjen e veprës penale, marrë parasysh transportin e tani të dëmtuarve - viktimave nga Kosova drejt vendeve të Bashkimit Evropian, prandaj të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën edhe është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar kundër tij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Andaj, gjykata të akuzuarit si më lart i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, i përgjigjet shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën i akuzuari edhe është shpallur fajtorë, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me dënimin e shqiptuar ndaj tij, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK, përkatësisht të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloi persona të tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, për ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Në këtë rast, gjykata është bazuar edhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, për një proces të hapur dhe të rregullt, që çdo person i akuzuar ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, duke pasur parasysh edhe bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij, si dhe në parimin që çdo person i akuzuar për një veprë penale të prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 449, par. 1 të KPP, kurse vendimi mbi taksën për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të neneve: 3; 6 dhe 39, par .3.2 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Për llogaritjen e masës së arrestit shtëpiak prej datës 04.10.2023 deri me datë 03.01.2024 në dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit, është vendosur konform dispozitës së nenit 83, par. 1 të KPRK.

Të dëmtuarit D.A., F.R.dhe A.B., nuk udhëzohen në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike sepse gatë shqyrtimit gjyqësorë kanë heqë dorë nga kjo e drejtë

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të neneve 273, par. 1 dhe 3 të KPRK, si dhe nenit 364 të Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë **06.06.2024**.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.331/2023, datë 29.05.2024.

Bashkëpunëtoreshë profesionale,
Arbenita Hoxha Koleci

Kryetari i trupit gjykues,
Naser Foniqi

UDHËZIMI PËR MJETET JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar **brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh** nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, me seli në Prishtinë.